

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                              |
|---------|----------------------------------------------|
| TITULLI | 24 orë para verdiktit                        |
| ADRESA  | https://tpz.al/24-ore-para-verdiktit-i333022 |
| BURIMI  | tpz.al                                       |
| GJENDJA | online                                       |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 15 shtator 2026, 19:40:12 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 19:34:11 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | b819926825e4460bfcf8699f9dcd96b204878c6f5031dacfd82e966c9f7f10d8 |
| TEKSTI     | e833aa47d8f82e7767107f6b20fa5b34fb546d28832fd396785bb961805e849f |
| PAMJA      | 426a305ac2dea1b118642c9f1d726887de7c7b6528223b2b850b229385a9d82c |

## ZINXHIRI I PROVËS

|                |                                                                                                 |
|----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE      | 8c0949ed544389f3166214423c620977553560c693834fc6b34b28f85ac3d664                                |
| E MËPARSHMJA   | —                                                                                               |
| RRËNJJA MERKLE | 9dbe3bb033f14c903d871b5f44056dbb0c7543241b7df3ea5dc415a83f1a9da2                                |
| ANKORIMI       | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8c0949ed544389f3166214423c620977553560c693834fc6b34b28f85ac3d664>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



FLASH!

19:09 Neutralizohet vatra e zjarrit në fshatin Andon Poçi të Gjirokastrës

18:35 Panik në Stamboll/ Të shtëna me armë në një dyqan, 3 persona humbin jetën

17:37 Ak

BLOG, 15 SEPTEMBER 2026, 21:34

## 24 orë para verdiktit

tpz.al

Nga Baton Haxhiu



Kosova duhet të përgatitet për pasojat e mundshme të një vendimi të rëndë, ndërsa politika duhet të sqarojë çfarë di dhe çfarë nuk di.

Gjyqtarët nuk zbresin nga qielli dhe shtetet nuk hyjnë në një ditë me pasoja të mundshme rajonale duke pritur që gjithçka ta mësojnë nga transmetimi televiziv. Pavarësia e gjykatës është detyrim për mënyrën si merret vendimi, por nuk përjashton komunikimin institucional, vlerësimet e sigurisë dhe përgatitjen politike. Megjithatë, përgatitja për pasojat nuk është e njëjtë me njohjen paraprake të aktgjykimit.

Ky është dallimi që duhet të udhëheqë debatin. Shtetet që mbajnë trupa ose personel në terren kanë arsye të kërkojnë vlerësime për rrezikun dhe masat e nevojshme. Qeveritë mund të analizojnë reagimet e mundshme, të përgatisin komunikimin dhe të planifikojnë mbrojtjen e personelit pa e ditur përmbajtjen e vendimit. Nga kjo nuk rrjedh automatikisht se atyre u është dorëzuar aktgjykimi.

Nga informacionet që kam marrë, drejtimi i pritshëm i verdiktit është komunikuar në qarqe shtetërore jashtë gjykatës, ndërsa mbeten të paqarta dënimet në vite dhe përfundimi për secilin emër. Këtë e paraqes si informacion nga burimet e mia, ende të pambështetur me dokument publik. Ai justifikon kërkesën për përgatitje ndaj një vendimi të rëndë, por nuk më jep të drejtë të shpall se cili prej katër të akuzuarve do të lirohet dhe cili do të dënohet.

Nesër, më 16 shtator, në orën 10:00, Dhomat e Specializuara do të shpallin aktgjykimin e shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Atëherë do të kemi vendimin zyrtar dhe arsyetimin e tij. Sot, pyetja kryesore është nëse Kosova po përgatitet për pasojat e mundshme dhe nëse institucionet e Kosovës, Qeveria në veçanti, po komunikojnë me ndershmëri kufijtë e asaj që dinë.

SHBA-ja, Britania, Gjermania, Franca dhe Italia, së bashku me strukturat e NATO-s dhe shtetet që mbajnë trupa në Kosovë, kanë arsye të drejtpërdrejta për të kërkuar vlerësime paraprake të

### ide!

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?

Nga Andi Bushati

Në Shqipërinë e sotme "revolucionin" ka emrin pjesëmarrje dhe alternative

Nga Preç Zogaj

### Tej e Këtej



Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

### Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Messenger

### Moti

Tirana, Albania

### WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori? Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

[Shiko të tjera video](#)

pasojave. Qeveritë në Prishtinë, Tiranë, Shkup dhe Beograd kanë gjurmashu interes të menjëhershëm politik. Por një vlerësim sigurie, një pritshmëri diplomatike dhe njohja e përmbytjes së aktgjykimit janë tri gjëra të ndryshme. Ato nuk bëhen të njëjta vetëm sepse kalojnë nëpër zyra të rëndësishme.

Nëse shteteve u është komunikuar paraprakisht drejtimi i vendimit, kjo kërkon shpjegim për burimin, qëllimin dhe kufijtë e këtij informimi. Nëse, përkundrazi, ato po veprojnë mbi analizat e shërbimeve dhe diplomatëve të tyre, atëherë përgatitja e tyre nuk duhet të paraqitet si provë se e kanë lexuar verdiktin. Në të dyja rastet, publiku dhe qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të kërkojnë llogari për mënyrën si po përgatitet Kosova. Konfidencialiteti operacional nuk mund të bëhet justifikim për mungesën e përgjegjësisë politike.

Këtu merr rëndësi edhe çështja e stafit të BE-së dhe EULEX-it. Informacionet për largim ose evakuim kërkojnë konfirmim. Pa të, do të ishte e pandershme të shkruhej se evakuimi ka filluar. Por, nëse po shqyrtohen masa të tilla, publiku duhet të dijë nëse bëhet fjalë për kujdes rutinë, kërcënim konkret apo vlerësim të reagimeve pas vendimit. Këto skenarë kanë domethënie të ndryshme dhe nuk duhet të ngatërrohen me njohjen paraprake të aktgjykimit.

Një plan për mbrojtjen e personelit nuk provon se dikush e ka lexuar verdiktin. Ai tregon vetëm se pasojat e mundshme po merren seriozisht. Prandaj pyetja për qeverinë është nëse po përgatitet me të njëjtin seriozitet edhe për qytetarët, familjet e të akuzuarve dhe komunikimin publik, apo do ta zbulojë peshën e ngjarjes vetëm pasi ta dëgjojë nga Haga.

Deklaratat e Vuçiçit duhen lexuar në këtë kuadër. Siguria që shfaq një politikan për një vendim të pashpallur mund të krijojë përshtypjen e qasjes në informacion dhe ta orientojë paraprakisht debatin. Nga retorika nuk mund të dimë nëse ai ka informacion të besueshëm. Mund të analizojmë vetëm interesin e tij për ta kthyer gjykimin në argument politik kundër Kosovës.

Nëse ka dënime, ekziston rreziku që ato të përdoren për të njollësuar gjithë luftën çlirimtare. Nëse ka pafajësi, vendimi mund të sulmohet si produkt i mbrojtjes perëndimore. Asnjëra mundësi nuk dëshmon asgjë por të dyja tregojnë pse Kosova duhet të përgatitet për betejën mbi interpretimin politik të vendimit.

Edhe qëndrimi i atribuar i kongresistit Keith Self-it, ditën e sotme, e zhvendos debatin drejt njëanshmërisë së mundshme dhe stabilitetit rajonal, ndërsa pasiguria e shprehur nga mbrojtja tregon se afërsia me procesin nuk prodhon domosdoshmërisht siguri për përfundimin. Këto qëndrime meritojnë vëmendje, por as deklaratat politike dhe as ankthi profesional nuk zëvendësojnë provat dhe arsyetimin gjyqësor.

Për këto arsye, duhet të përgatitemi për skenarin më të rëndë, pa e shpallur paraprakisht fajësinë e askujt. Institucionet duhet të kenë plane për reagimin politik e të sigurisë, familjet duhet të mbështeten dhe opinionin nuk duhet të ushqehet me premtime pafajësie që askush nuk mund t'i garantojë. Kjo është përgjegjësi shtetërore, jo dëshmi se aktgjykimi është i njohur.

Kosova duhet të kërkojë drejtësi për secilin të akuzuar dhe respekt për çdo viktimë. Kritika ndaj aktgjykimit duhet të mbështetet në atë që gjykata ka provuar dhe në mënyrën si e ka arsyetuar vendimin. Pakënaqësia mund të jetë e fortë dhe publike, por dhuna vetëm do t'u jepte kundërshtarëve argumentin që kërkojnë.

BE-ja doli me qëndrim për pasojat, pavarësisht se vendimi i shkallës së parë ende kishte të drejtën e apelit. Kjo e paragjykonte vendimin dhe krijonte përshtypjen se përfundimi ishte trajtuar si i ditur para se të përfundonte procesi gjyqësor. Por, çfarëdo që të vendosë gjykata, Hashim Thaçi mbetet figurë historike e luftës çlirimtare dhe e shtetformimit të Kosovës. Një aktgjykim ndaj një individi nuk mund të fshijë historinë e një populli dhe as të barazojë përgjegjësinë individuale me fajësinë kolektive.

Të gjitha versionet për dy të liruar, katër të liruar apo katër të dënuar mbeten të pakonfirmuara deri në shpallje. Autoriteti për të vendosur i takon trupit gjykues, ndërsa përgjegjësia për t'u përgatitur për pasojat i takon politikës. Një qeveri nuk mund të kërkojë besim për atë që thotë se nuk di dhe, njëkohësisht, të shmangë llogarinë për atë që duhet ta kishte parashikuar.

BLOG / 6 September 2026, 10:52

## Pse janë kaq të shëmtuar filmat e rinj shqiptarë

Nga Ben Blushi

BLOG / 4 September 2026, 16:39

## Pasqyra dhe florini

Nga Thoma Gëllçi

BLOG / 3 September 2026, 14:33

## Lej Fenët, Made in Albania!

Nga Lutfi Dervishi

BLOG / 1 September 2026, 16:23

## Pse ndërtimi është kthyer në një sektor të rrezikshëm për ekonominë?!

Nga Irena Beqiraj

BLOG / 31 August 2026, 20:42

## Mjeku, pacienti dhe pasqyra

Nga Lutfi Dervishi

BLOG / 31 August 2026, 14:29

## Vdekja e Mlladiqit nxjerr në pah përballjen e papërfunduar të Ballkanit me krimet e luftës

BLOG / 28 August 2026, 18:18

## Metamorfoza agresive e burrave shqiptarë dhe gangsterizmi si stil jetese

Nga Kreshnik Spahiu

BLOG / 21 August 2026, 10:14

## Pse duhet të bëjmë një film ndërkombëtar për Skënderbeun

Nga Ben Blushi

BLOG / 18 August 2026, 16:14

**A do të protestojmë për vdekjen e turistit të huaj apo vetëm për ngordhjen e zogjve?**

Nga Kreshnik Spahiu

BLOG / 17 August 2026, 20:09

**Pse Rama nuk tërhiqet dot nga Zvërneci**

Nga Andi Bushati

BLOG / 13 August 2026, 11:15

**A mund të bëhet Shqipëria një shtet më i madh sipas Marko Rubios?**

Nga Ben Blushi

BLOG / 9 August 2026, 20:34

**Dy mijë vjet mësimë dhe ende nuk kemi mësuar!**

Nga Lutfi Dervishi

BLOG / 3 August 2026, 17:37

**Huqi del me shpirtin**

Nga Lutfi Dervishi

BLOG / 2 August 2026, 22:24

**Pse zogjtë e bufit janë më të mirë se zogjtë e qyqes dhe se zogjtë e tu**

Nga Thoma Gëllçi

BLOG / 26 July 2026, 13:33

**Qenke lodhur kot, tani mjafton BESA**

Nga Lutfi Dervishi

BLOG / 19 July 2026, 12:18

**Sqarim për 'qenien e pështirë', patronazhistin**

Nga Lutfi Dervishi

BLOG / 19 July 2026, 11:33

BLOG / 6 July 2026, 12:09

Shpella e Ciklopit në Himarë,  
filmi “Odisea” i Nolan dhe  
lavazhi i makinave

Nga Auron Tare

Rruga jonë drejt BE-së është  
penguar nga korrupsioni,  
krimi i organizuar,  
institucionet e politizuara dhe  
kapja oligarkike e pasurive  
publike

Nga Ditmir Bushati

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.